

MINISTRIA E MBROJTJES
NJOFTIM FITUESI

Për: Operatorin Ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W

Adresa: Rruga “Besim Imami”, “Myslym Shyri”, mbrapa Karburantit, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e kufizuar” - (prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë).

Numri i referencës së procedurës/lotit : Urdhër Prokurimi nr. 226, datë 10.02.2025, i titullarit të autoritetit kontraktor.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti nr. II., me objekt “Ndërtim vend kontrolli teknik automjeteve”, me fond limit 10,770,791 (dhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, i procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i vendqëndrimit të rojeve, portave hyrëse dhe vend kontrollit teknik të automjeteve në zonat A, B dhe C, të Repartit Ushtarak nr. 4030 (BMEC), Ferraj, Tiranë”.

Publikime të mëparshme: Publikimi i njoftimit të kontratës - Buletini i Njoftimeve Publike nr. 12, datë 10 Mars 2025.

Kohëzgjatja e kontratës : Pesë muaj nga fillimi i punimeve.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët X.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me ofertë ekonomike me vlerë 10,545,082.90 (dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e pesë mijë e tetëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm: Nuk ka ofertues të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 10,545,082.90 (dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e pesë mijë e tetëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë rruga e Dibrës, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në njoftimin e fituesit, atëherë autoriteti kontraktor do të konfiskojë sigurimin e ofertës, sipas parashikimeve në nenin 18, paragrafi 3, të Rr.P.F.M.S.

Në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 54 të ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, periudha e pritjes nuk zbatohet.